

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr.112, date 27.2.2004

PER DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.155, DATE 25.4.2002, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, "PER FUNKSIONIMIN, TE DREJTAT DHE DETYRAT E ENTIT SHTETEROR TE FARERAVE DHE FIDANEVE"

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 11, te ligjit nr.8732, date 24.1.2001, "Per materialin mbjelles bimor", me propozimin e ministrit te Bujqesise dhe te Ushqimit, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ne piken 3, te vendimit nr.155, date 25.4.2002, te Keshillit te Ministrave, te behen keto ndryshime:

a. Shkronja "b" ndryshohet, si me poshte vijon:

"b. Kryerjen dhe mbikeqyrjen e provave te testimit te varieteteve te reja te bimeve te kultivuara, te krijuara ne vend ose te ardhura nga vendet e tjera, per vleren e kultivimit e te perdorimit (VKP) dhe per dallueshmerine, uniformitetin e stabilitetin (DUS).

Provat zyrtare te testimit te varieteteve te bimeve te arave kryhen per:

- varietetet e krijuara ne vend, ne jo me pak se dy vjet;
- varietetet qe perfshihen ne regjistrin e OECD-se, ne jo me pak se nje vit, dhe, pas kualifikimit, ato perfshihen ne katalogun zyrtar;
- varietetet e regjistruara ne vendet e tjera, parce nuk perfshihen ne regjistrin e OECD-se, ne jo me pak se nje vit dhe vetem per vleren e kultivimit e te perdorimit (VKP);
- varietetet e bimeve drufrutore, ne jo me pak se dy vjet pas hyrjes se tyre ne prodhim.

Kryerja e provave zyrtare te testimit te varieteteve te bimeve te kultivuara realizohet, ne jo me pak se dy zona, qe perfaqesojne kushte te ndryshme klimatike.

Zonat ku do te kryhen provat zyrtare te testimit te varieteteve jane: Tirana, Shkodra, Dibra, Korca, Lushnja dhe Vlora."

b. Shkronja "e" ndryshohet, si me poshte vijon:

"e. Botimin e katalogut zyrtar te specieve dhe varieteteve te bimeve te kultivuara cdo vit, brenda muajit shkurt. Ndryshimet qe behen gjate vitit publikohen, periodikisht, nga Enti Shteteror i Farerave dhe Fidaneve."

2. Ngarkohet Ministria e Bujqesise dhe e Ushqimit per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
FATOS NANO

MINISTRI I BUJQESI DHE I USHQIMIT
AGRON DUKA